




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria pâr Administratë tê përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 3021 Më 01.10.2019
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC



KOMUNA E RAHOVECIT

OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

KONTRATË

Emri i Autoritetit Kontraktues: **KOMUNA E RAHOVECIT**, në njëren anë; dhe

Emri i Kontraktuesit: "**VLADIMIR MORAVČEVIĆ**" I. B. me adresë në Rahovec, të cilën e përfaqëson **Vladimir Moravčević**

Janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për:

TITULLI I KONTRATËS: BARTJA E NXËNËSVE NË RELACIONE PËR VITIN SHKOLLOR 2019/2020 – Ritenderim

Numri i Prokurimit: 623-19-6904-2-3-6

Numri i Brendshëm: 623-19-049-2-3-6

Lot V – BARTJA E NXËNËSVE NË RELACIONIN HOÇË E MADHE – RAHOVEC DHE ANASJELLTAS PËR VITIN SHKOLLOR 2019/2020

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Lot V – BARTJA E NXËNËSVE NË RELACIONIN HOÇË E MADHE – RAHOVEC DHE ANASJELLTAS PËR VITIN SHKOLLOR 2019/2020**, sipas specifikimeve teknike të detyrueshme dhe pjesës së ofertës financiare që janë pjesë e kësaj kontrate.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me: datën e nënshkrimit dhe përfundon për një periudhë prej 10 Muaj.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se [2] ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë: **Në Komunën e Rahovecit**.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik tê Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridikzioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **4,495.50 Euro;**

(Katërmijë e katërqindenëtëdhjetë pesë Euro e pesëdhjetë Cent).

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtronen ndryshimin të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë:

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatinin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i Shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për....muaj, pas pranimit të shërbimeve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të realizoj ndonjë ose te gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njofim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimin apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktuje pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik përvendimin e tij brenda 5 ditëve nga marja e njofimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b)

PËRSHKIMI I GMIMeve:

BARTJA E NXËNËSVE NË RELACIONE PËR VITIN SHKOLLOR 2019/2020

Lot V – BARTJA E NXËNËSVE NË RELACIONIN HOCË E MADHE – RAHOVEC DHE ANASJELLTAS PËR VITIN SHKOLLOR 2019/2020

Shkolla	Relacioni	Distanca ne km	DTB	Nr. Nxenesve	Cmimi € Nje ditë punë (18 km)	Cmimi € Për muaj	Shuma totale €
Lot V – BARTJA E NXËNËSVE NË RELACIONIN HOCË E MADHE – RAHOVEC DHE ANASJELLTAS PËR VITIN SHKOLLOR 2019/2020	Hocë e madhe - Rahopec	16.00 km	185	16	24.30	558.90	4,495.50
				Total:			4,495.50

Bartja e nxënësve



Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatini e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimeshit nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës përmë shumë se 180 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jep Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen [Shqip]² në tri origjinalë, dy origjinalë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues:		Për Kontraktuesin:	
Emri:	Astrit Mullabazi	Emri:	Vladimir Moravčević
Pozita:	U.d. Menaxher i prokurimit	Pozita:	Drejtësor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	01.10.2019	Data:	01.10.2019
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.